

UDHA ISLAMIE

Viti XI - Nr. 12 (130), Dhjetor, 2013

Organ i Myftinisë Shkodër

E përmuajshme Informative-Fetare-Kulturore-Edukative

VITI 2013- VIT I DEKADENCËS SHPIRTËRORE

TË NJERIUT BASHKËKOHOR...



VITI 2013 - VIT I DEKADENCËS SHPIRTËRORE TË NJERIUT BASHKËKOHOR...



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Po ndiqja një emision special mbi ndodhitë kryesore të vitit 2013 në kanal televiziv satelitor "Al-Jazeera". Dy gazetarët, si në një bashkëbisedim, përsërisnin ndodhitë e këtij viti, duke u përqendruar tek "pranvera (e kobshme) arabe" dhe të tjera ndodhi, që të gjithë ne, në një mënyrë a një tjetër, përjetuam së bashku-

Për një moment e largova vëmendjen nga emisioni në fjalë dhe sa hap e mbyll sytë, solla në orbitën e kujtesës së afërt ngjarje e ndodhi, të cilat, për mendimin tim, shenjua rrugëtimin e këtij viti dhe regjistrimin e tij në arkivat e historive të errëta, dekadente e larg rritjes cilësore të sjelljes së racës njerëzore në skenat e jetës.

Viti 2013, me gjithë atë që pamë e dëgjuam, u shënua si një ndër vitet më të errëta të historisë së njerëzimit. Njeriu bashkëkohor, me gjithë arritjet në teknologji, shkencë, mjekësi e shumë lëmi të tjera, u dëshmuua si model xhungre, pa shpirt, pa mëshirë, pa vlera, plot injorancë e imoralitet!

Njeriu i vitit 2013 dështoi në rrugën e vërtetimit se është i denjë të dëshmojë vëllazërinë e shenjtë hu-

mane, atë për të cilën Zoti i njeriut, nëpërmjet Librave të Shenjtë, e ka ftuar atë ta dojë e ta respektojë vëllanë e tij human, të dojë për tjetrin atë që do për vete, të mos punojë pas krahëve, të mos vrasë, të mos bëjë tregëti me imoralitetin etj.

Me veprën e tij, njeriu bashkëkohor i vitit 2013 vërtetoi dekadencën dhe rrugëtimin në labirinthet e

errëta të injorancës dhe fanatizmit ekstremist e vrasar, pa mëshirë e dhembshuri, pa ndjenja njerëzore....

Në këtë vit të errët për njerëzimin, vitin 2013, u vranë me mijëra të pafajshëm në mbarë botën, nën sytë dhe vëzhgimet e verbëruara të "botës së qytetëruar", që si përherë në traditën e saj dinake, u radhit në

Njeriu i vitit 2013 dështoi në rrugën e vërtetimit se është i denjë të dëshmojë vëllazërinë e shenjtë humane, atë për të cilën Zoti i njeriut, nëpërmjet Librave të Shenjtë, e ka ftuar atë ta dojë e ta respektojë vëllanë e tij human, të dojë për tjetrin atë që do për vete, të mos punojë pas krahëve, të mos vrasë, të mos bëjë tregëti me imoralitetin etj.



njërin krah të vrasjes dhe të zjarrit!
U bombarduan qytete e fshatra, për faturë të një qytetërimi të dështuar e një sistemi të ri dështak në rru-
gën e rritjes së cilësisë së jetës mbi Tokë!

Mbetën jetimë me mijëra fëmijë të pafajshëm, sidomos në botën islame e atë arabe, në përmbushje të axhendave politike të krimit, vrasjes e shfarosjes së Tjetrit, në një botë pa drejtësi, pa shpirt, pa besim, pa frikë për një ditë llogarie!

U dogjën muslimanë të pafajshëm nga duar terroristësh budistë, të mbështetur edhe nga një heshtje totale botërore, për një prej krimeve më makabre të historisë së njerëzimit!

U shkatërruan xhamitë dhe u ndalua feja islame me ligj, nga fanatizmi dhe ekstremizmi i verbër, në emër të shumicës katolike në Angola... (Vërtetë, botë e tretë, por edhe ky etiketim është stacion prej stacioneve të dekadencës shpirtërore të njeriut bashkëkohor!).

Por, viti diellor 2013 dëshmoi edhe vullnete befasuese kthese, si ai i regjizorit hollandez Arnoud van Dorn, i cili në shkurt të këtij viti u kthye në musliman, pak kohë pasi Geert Wilders, Kryetari i Partisë së Lirisë së ekstremit të Djathtë (pjesë e së cilës ishte edhe van Dorn, regjizor i një filmi të ulët në hak të profetit Muhammed), lëshoi një websit personal të quajtur: "Jo xhamive" në Hollandë- Sepse përherë ka shpresë, sepse kjo gjithësi e ka Një Zot, të Vetëm, të Pashoq!

Në Shqipëri, shejtani me bijtë e tij besnikë, vazhdon të tallet me muslimanët autoktonë të këtij vendi, duke mbajtur peng ndërtimin e xhamisë katedrale në mes të Tiranës, por jo vetëm, në një kohë kur gojët e palara të shumëkujt, në ditë festash fetare përsërisin pa ia nda se: "modeli shqiptar i harmonisë ndërfitare" ia vlen të prezantohet edhe mëtej në botë...

Por, viti diellor 2013 dëshmoi edhe vullnete befasuese kthese, si ai i regjizorit hollandez Arnoud van Dorn, i cili në shkurt të këtij viti u kthye në musliman, pak kohë pasi Geert Wilders, Kryetari i Partisë së Lirisë së ekstremit të Djathtë (pjesë e së cilës ishte edhe van Dorn, regjizor i një filmi të ulët në hak të profetit Muhammed), lëshoi një websit personal të quajtur: "Jo xhamive" në Hollandë- Sepse përherë ka shpresë, sepse kjo gjithësi e ka Një Zot, të Vetëm, të Pashoq!

Viti diellor 2013 shkoi... Shkoftë e keqja me të, ndonëse të njëjtat fytyra të modelit 2013, do vazhdojnë të dëshmojnë kjo botë edhe në këtë 365 ditësh të ri me numrin 2014..., ndonëse e kemi për detyrë të lutemi që kjo botë të pastrohet nga ky model ateist, ekstremist, fanatik dhe i verbër!

Cila është zgjidhja e këtij ngërçi, në të cilin ka hyrë njeriu i shekullit të ri, duke u dëshmuar pa shpirt e pa ndjenjë, pa zemër e pa moral? Është e njëjta zgjidhje, si ajo që përherë njeriu e ka pasur në dorë; kthimi nga Zoti, Krijuesi i njeriut, krijuesi i tanësisë. Vetëm Ai nuk na e ka me hile!

Shkodër, 31 dhjetor 2013





Gëzim Kopani
Myfti i rrethit Pukë

Në vitet **1900-1923** Myftinia e rrethit Pukë përveç vendeve që mbulon sot, ajo mbulonte edhe disa vende të tjera si: **Dukagjini, Petkaj, Mëgull** (Me-gjull), **Spaç, Pistë, Shikaj, Shumri**, **Kalimash** etj që sot mbulohen nga **Myftinia e Kukësit**. [1]

Kleriku mysliman i Pukës ishte i njohur për kontributin e dhënë për Liri e Pavarësi e argumentuar kjo qoftë përmes gojdhaneve dhe kujtesës historike por edhe përmes burimeve arkivore.

Përpjekja e hoxhallarëve pukjanë për Liri e Pavarësi kulmon në vitet **1911-1912** ku hoxhallarët ishin të parët që kundërshtuan pushtuesin.

MUSA ET'HEM DIZDARI **(1800-1900)**

Musa Et'hem Dizdari njihet si i pari imam vendas, për të cilin ruhen kujtime dhe burime arkivore për veprimtarin e tij Atdhetare. **Hoxhë Puka, Ismail Salih Age Kryeziu** organizuan largimin e **Haxhi Ymer Prizrenit** prej Prizrenit deri në kufi me Pukën. [2]

Për **Haxhi Ymer Prizrenin** ishte lëshuar urdhër për kapjen e tij, si organizator “i kryengritjes që kishite themeluar dhe kishte përgatit ai”, kundër Perandorisë Osmane gjatë *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* **1878-1881**. [3]

Edhe Kryeministri në shkresën e tij, shoqëruar aktet gjyqësore Pallatit Perandorak, Sulltanit, thekson se “**Ismail Agai dhe Hoxha i Pukës, Musa efendiu, kanë qenë nga njerëzit**

Kontributi i hoxhallarëve pukjanë për Liri e Pavarësi (1881-1912)

e rrëzikshëm që patën trubulluar dhe prishur qetësinë e vendit.” [4]

Në bazë të këtyre akteve hoxha sëbashku me të tjerët u internuan “me rrugën e Selanikut dhe të Aleksandrisë për në Merash.” Në fshatin **Kryezi** tregonin se hoxha ka pas përfunduar deri në **Halep të Sirisë**, ku u mbajtën në internim për afro pesë vjet. [5]

Musa Hoxhë Puka së bashku me **Ismail Age Kryeziu** më **14 korrik 1965**, me dekret nr. **4040**, dekorohen prej **Presidiumit të Kuvendit Popullor** me “**MEDALJA PËR VEPRIMTARI PATRIOTIKE**”

ISUF ARIF HOXHA (1820-1919)

Isuf Arif Hoxha i mbiquajtur *Hoxha i Madh*, ka qenë hoxhë i xhamisë **Iballe**. Ka përkrah *Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*. **Imam Isuf Hoxha** ka mësuar në Medresenë e Prizrenit ku u përgatit për imam. Ai kishte lidhje me **Dizdarin** e Pukës, se kishte gruan prej asaj derë, **Gjylen**.

Këto lidhje miqësie i bashkoi më shumë në përkrahjen e *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*. Imam Isufi ishte nip i **Cecë Halilit** të **Dardhes**, burri trim dhe guximtar. Ai kishte edhe lidhje të tjera me kabashës të tjerë të **Dardhës** atë të **Mëziut** si “dajë” siç ishte rasti i **Mark Balës** së Mëziut i cili u sëmur në **Mertur**, ku kishte shkuar për festë dhe erdh e vdiq në kullën e imam Isufit ku e varrosi me nderime **Mark Bal Gjonin**.

ZENEL ADEM HOXHA **(1853-1945)**

Zenel Adem Hoxha ka qenë imam i Xhamisë **Kadërhani Pukë** si dhe Myfti i rrethit të Pukës, “**Qytetar Nderi**” i Pukës. [13] Ishte ditë e Xhuma ku imam **Zenel Hoxha** po mbante hytben e xhumasë dhe të pranishëm ndër të tjerë kishte **Shefqet Turgut Pashën**,

korrik **1910** (Ministër i brendshëm Turk), si dhe **Adil Beut** dhe **Hasan Riza Pashës**. Imam **Zenel Hoxha** në hytbe u shprehur: “*Allahu e ka dhënë që çdo popull të jetoi në Liri në vend të vet.*” [6]

Në shkrimin “*Kryengritja e Pukës rreth vjetit 1912*” sado që pranohet e “*Nuk duhet lënë pa përmendë edhe z. Zejnel Hoxha i Pukës... qysh në fillim qe simpatizues i lëvizjes, e kurdo ku e qitite rasa,... batë një sjoj propogande në favor të kryengritjes.*” [7]

SADIK PRISHTINA (1892-1977)

Imam **Sadik Prishtina** ishte nga fshati **Kraishtë** i **Lipjanit** të **Kosovës**. Ai u perkrah nga i ati **Hasimi** i cili e dërgon për studime islame në Mejtëpin e **Janjevës** dhe për të vazhduar në Medresenë e Prizrenit. Me fillimin e *Luftës Ballkanike* vendi u pushtua nga ushtria sllave.

Gjatë qëndrimit në *Prizren*, përveç aktiviteteve fetare **Sadiku** i ndikuar edhe nga kultura islame sëbashku me disa bashkëkohorë formuan organizatën “*Bashkimi Kombëtar Shqiptar.*” [8]

Për një fare kohë ai shërbeu si imam i **Vaspasit**, që i dha i pari kushtrimin e fillimit të luftës në **Malzi** kundër pushtuesve serbë, si dhe **Osman Hoxha i Fletit**. Heroizimi i tyre u këndua në këngë popullore:

“*Kush e nisi luftën për Dri?!
Hoxhallarët e Malitzi!
Sadik Hoxha, djali zotni,
Trim për pushkë e zanatli!*” [9]

OSMAN HOXHA (1847-1912)

Sipas Prof. Dr. **Bajram Xhafa** kemi: “Në rrugën e divizioneve serbë nga **Gjakova** dhe **Prizreni** për të dalë në **Lezhë** e **Shëngjin**, tradita popullore ruan shumë kujtime me vlerë që pa-

sqyrojnë qëndresën e fshatarëve së krahinës së **Malëziut** (banuar thuajse tërësisht me popullsi myslimane si **Va-Spasi, Pista, Gdheshta, Mgulla, Fleti** etj.) për mbrojtjen nga rrebeshi i ushtrisë serbe.

*“Kush ja vuni pushkën serbit,
Osman Hoxha past rahmet”*[10]

Për këtë arsye krahina u dogj plotësisht. Në *Gdheshtë* u therën 72 gra, pleq e femijë që ranë në duart e serbëve. Në fshatin *Flet* më **15 nëntor** serbët humbën edhe reparte të tëra. Bashke me ta luftuan banorë e fshatrave të tjera si: **Dardha, Truni, Sakati, Xathi**, që bashkëpunonin me atë të **Qafës së Malit, Fush-arrezit** e deri në **Pukë**.”[11]

Osman Hoxha u rrit në një familje besimtare dhe patriote. Që i vogël Osmani sëbashku me babain e tij kryenin ritet fetare në xhamin e fshatit **Kulumri**. [12] Sipas të dhënave **Osman Hoxha** ka marr mësimet islame në mejtepin e **Pukes** dhe të **Kabashit**.

Për disa vite pasi mori mësimet islame, ai u aftësua të drejtonte shërbimet islame si imam. **Myftinia e rrethit Pukë** që në moshë të re e emron **Osman Hoxhen** imam të xhamisë **Kulumri**. [13]

Sipas të dhënave **Fleti** ishte betuar sëbashku me *Udhmadhen* se do të luftonin me të gjitha mundësitë pushtuesin serb.

Sipas prof. **Xhemal Meçi** kemi:

“**Fleti** me *Udhmadhen* ishin betuar se do ta luftonin pushtuesin serb. Më **11 nëntor 1912**, kur vetem në **Gdheshtë, Malzi**, therën e masakruan 72 pleq, fëmijë e gra. Sapo pararoja serbe e Divizionit famkeq “*Drina*” arriti te mullini i **Fletit** imam **Osman Hoxha**, që kishte zënë vend mbas *Hanit* të **Fletit**, u vuri pushkën. Më shpejtësi vrau tre ushtarë serbë, të cilët i qitën rrethimin dhe e plagosën rëndë. Por, ndërsa qëndronte thirri myezinin e tij **Bajram Haziri**: “*O bini*

serbit se na qarti, bre!” [14]

Bajram Haziri lëshoi kushtrimin: “*Bini serbit, kush asht burr, se na vran Osman Hoxhën!*” dhe shtiu drejt kolonës serbe që po i ngjitej luginës së **Fletit**. Mbas kushtrimit e pushkës së tij e gjithë lugina e **Fletit** u ndez flakë prej armëve të fletasve dhe sakajaneve të **Vaspasit**, të tërhequr mbas luftimeve të ashpra që kishin zhvilluar me pararojen e ushtrisë serbe, ku mbetën të vrarë 20 ushtarë dhe komandanti i tyre, përball istiakmit (pozicionit) të **Ismail Arifit**, i cili ra dëshmor i Atëdheut, por u përjetësua edhe në këngë, ashtu si fletasit me **Osman Hoxhen**.

Në një këngë tjetër për luftën me serbë, **Vaspas - Flet**, mund të shkëpusim këto vargje:

*“Kush e nisi luftën me serbë?!
Osman Hoxha, past rahmet!
Osman Hoxha e Baram Haziri.*

*Qesi djemsh na i ka Fletit!
S'i ka krajl, s'i ka mbreti!
S'i mban toka, s'i mban deti!*

*Gjasht taborre kan mbet prej heri!
Gjasht taborre kan mbet prej 'i dit!
Dy mij vet kan dal komit.”* [15]

Për luftën me serbë **Vaspas-Flet** kemi edhe këtë këngë:

*“Kush e nisi luftën i pari?!
E kan nis dy hoxhallare!
Hoxhallart e Malitzi!*

*Sadik Hoxha ish kan dai,
Osman Hoxha 'i shehitli!...
Ka nis luftën me Serbi!*

N'ujt e Goskes jan mbyt nji mije!” [16]

Ishin mësimet dhe predikimet e hoxhallarëve pukjanë që inspiruan shumë mysliman të tjerë pukjanë që luftuan dhe ranë për Atëdheun. Nga ky inspirim madhështor në mbrotje të Atëdheut ranë dëshmorë për Liri

e Pavarësi nëntë dëshmorë pukjanë që luftuan në mbrotje të **Pukës** e **Shkodrës**.

[1] Informacion i grumbulluar nga **Gezim Kopani** në vitin **2005**.

[2] **Ymer Prizreni**, Kryetar i Komitetit Drejtues të *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*.

[3] Vendimi i *Gjykates Ustarake Shkodër* dhe i akteve *Gjyqësore të Ministrisë së Luftës* i datës **19 gusht 1881**.

[4] Përgjigjia e Sulltanit, datë **15 nëntor 1881**.

[5] Akademia e Shkëncave, Instituti i Historisë, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* në dokumentet **Osmane 1878-1881**. Tiranë, **1978**, fq.228.

[6] Nga Prof.**Xhemal Meçi**.

[7] K.B. M., “*Kryengritja e Pukës rreth vjetit 1912*”, **Hylli i Dritës. Shkodër**, **10/1937**, 15 tetor, fq.468.

[8] **Nexhmie Luma Prishtina** (Mbesa e imam **Sadik Prishtina**)

[9] Nga Prof.**Xhemal Meçi** (**Flet, 17 gusht, 1983**. MHP)

[10] **Osman Hoxha**, Hoxha i fshatit **Flet**, dhe **Bajram Haziri** e nisen të parët pushken kundër ushtrisë serbe dhe pas tyre u ngrit e gjithë zona e **Malëziut** të **Pukës**. Hoxha u plagos rëndë dhe pas disa ditësh vdiq nga plagët. (Marr nga: Prof.Dr. **Bajram Xhafa** revista “**Zani i Naltë**”nr.03 (156) fq.37, viti **2013**.

[11] **Murzaka**, Th., “Politik...”,fq. 147-148. Edith Durham shkruan: “*Duke përjashtuar Fletin, ku fshataret myslimane u bënëatyre një qëndresë prej tre ditësh në një grykë të ngushtë, ata e përshkruan tërë vëndin pa vështirësi, meqenëse Mirditorët kishin kaq pak armatime, saqë abati i tyre i bindi se lufta vetem do të shkaktonte masakra.*” “**Lufta për Shkodrën**”, Shkodër, 2005,fq.187.

Edhe **Sëire** shkruan se “*më përjashtim të Fletit, ku aty u bllokuan për tri ditë, gati nuk ndeshen në qëndresë... Prenga (Doçi-abati i Mirditës) planifikonte një kompromis me serbët*” (J.**Sëire**, “Shqipëria..” fq.127) Marr nga Prof. Dr. **Bajram Xhafa**, *Gjenocidi serbo-malazezo-grek mbi popullsinëmyslimane shqiptare (1912-1913)*, Revista “**Zani i Naltë**” nr.03(156) fq,37,viti **2013**.

[12] Xhamia e fshatit **Kulumri** shërbente për këto fshatra: **Kulumri, Flet, Xathë** dhe **Sakat**.

[13] Informacio i grumbulluar nga **Gezim Kopani** në vitin **2005**.

[14] **Baram Haziri**, Myezin i Xhamisë **Kulumri**, bashkë fshatar dhe shok i **Osman Hoxhës**.

[15] Visaret e Kombit, vll.IV. Tiranë, **1939**, fq.58-59, mbledhe në **Lumë, Kukës**.

[16] Studiuues Prof. **Xhemal Meçi**, “*Roli i prijësve mysliman të Pukës për Liri e Pavarësi*” Pukë më **24 nëntor 2012**.



Dr. Mustafa Mahmud

Dashuria... futbollit... televizionit... muzika... internetit... dhe kontraktivët.

Kjo është bota e sotme...

Dikur në një kohë i dashuruari i përvëlur ecte gjithë turp... shikim, buzëqeshje, përshëndetje, bisedë, pastaj takim, puthje, përqafim dhe fejesë e martesë... ndërsa sot në Perëndim marrëdhënia fillon nga fundi i saj, me kontraktivë... pastaj pyesin njëri-tjetrin për emrin, fillon biseda nga fundi... si nëpër filmat flashback.

Martesa moderne tani është martesa e Cary Grant-it (80 vjeç) me Barabara-n (30 vjeçe). Martesë platonike me qëllim shoqërimin e mirë dhe bisedat para gjumit.

Drogën tani nuk e qen në duart e njerëzve të moshuar, por në duart e fëmijëve të shkollave.

Koha e nxitimit!!?

Fëmijët 16-vjeçar duan të kenë bërë çdo gjë dhe të heqin dorë prej çdo gjëje... pastaj shikon ndonjërin prej tyre në moshën 17-vjeçare që palos plaçkat dhe niset për udhëtime turistike rreth botës.

Vendi i turizmit dje ishte për të rriturit, ndërsa sot gjejmë djem dhe vajza në moshë të njomë ku çdonjëri prej tyre mbartë në shpinë e tij strehën e vet duke kërkuar për ndonjë vend në trotuar, sikur toka me gjerësinë e saj të ishte dhoma e tij e veçantë e gjumit.

A ËSHTË KJO BOTË E ÇMENDUR?

Kur të arrijë të 20-at, atëherë ëndërrat e famës e të krenarisë i shikon gjithashtu me të njëjtën natyrë nxitimi. Ai mendon të zërë faqet e para të gazetave, duke vrarë presidentin e Amerikës, apo duke i bërë atentat papës... dhe n.q.s e pyet përse e qëlllove? Me qetësi thotë: Sepse bota po ec në një mënyrë që nuk më pëlqen... ose thotë, duke qeshur, për sytë e të dashurës sime, sepse i kam premtuar se do të bëj diçka të jashtëzakonshme.

Natyra e tij është ajo që sundon të riun e ia imponon sjelljet dhe jo doktrina. Zgjedhja e doktrinës vjen si rezultat i natyrës. Natyra e gjakut të refuzimit e të urrejtjes zgjedh doktrinën e rebelimit që t'ia justifikojë qëllimin e t'i japë krimin të tij një formë filozofike të pranueshme përpara të tjerëve, ku ai mund të jetë marksist, i majtë, proletar që lufton për parimin e tij.

Por, në të vërtetë ai nuk ka parim, përveç shkatërrimit. Ai është mashtrues dhe harta e doktrinës botërore e vërteton këtë gjë. Ja, shiko komunistin që vret komunistin në Kamboxhia... marksistin që vret marksistin në Vietnam dhe Kinë... myslimani që vret myslimanin në Iran... të krishterin që vret të krishterin në Irland... beatistin që vret beatistin në Siri dhe Irak... nacionalisti arab që vret nacionalistin arab në çdo vend.

Veprat përgënjeshtrojnë pretendimet ... dhe për çfarë konfliktuonë?!!

Ata ngrenë lartë të njëjtin flamur dhe me gjithë këtë ata vrasin njëri-tjetrin.

Çfarë kërkojnë në të vërtetë?

Ajo është natyrë gjakësore që

vesh rroba ideologjike mashtruese.

E vërteta lakuriq është se atje nuk ka parim, përveç epshit të vrasjes.

Për këtë, sa herë që ndonjë bandë prej këtyre bandave pothuajse arrin të ndryshojë formën e sistemin, kur menjëherë fillojnë spastrimet e njëri-tjetrit, vrasjet e udhëheqësve me oreksin e spastrimeve të ethshme, derisa të mos mbetet, përveç më gjakatarit, e ai është manipulatori më i madh.

"Kështu ne kemi bërë për çdo vend

Allahu na ndihmon neve të kuptojmë këtë mister duke na thënë se Ai e ka krijuar qenien njerëzore të aftë për çdo gjendje dhe situatë të lartë dhe të ulët.

kriminelë të mëdhenj që manipulojnë në të..." (En'am: 123).

Atëherë, ata janë kriminelë të mëdhenj, jo më shumë.

Të gjithë janë në konflikt, jo për shkak të parimeve, apo konflikteve të ideve, por për shkak të ndryshimeve mes një kriminelit dhe një kriminelit tjetër me më shumë krime... lufta për pushtet... kush është mashtruesi më i madh... konflikt për pozicionin e tiranit dhe të pushtetit... të gjithë janë mohues të çdo gjëje, përveç vetes, pushtetit dhe tiranisë së tyre.

"Me të vërtetë, ata të cilët nuk besuan janë në tirani dhe konflikt". (Sad: 2).

Këto janë karakteristikat e botës materiale idhujtare që nuk beson, vetëm në momentet urgjente dhe në plaçkitje dhe përfitim.

A e ka humbur bota mendjen e saj?

Jo, madje ajo ka arritur kulmin e mendjes së saj. Ajo ka ecë për mbi hënë dhe ka zbritur anije në Mars. Ka mbjellë embrionin në laborator, ka transplantuar zemrën e të vdekurit te trupat e të gjallëve. Ka arritur të shërojë sëmundjen e lijës, të paralizës së fëmijëve dhe tifos, ka ndërtuar qiellgërvishtësit, ka gjelbëruar shkretëtirat dhe ka pushtuar universin.

Atëherë, si ka mundësi që shpenzon çdo ditë miliona e miliarda për të prodhuar raketa e bomba shkatërruese dhe gaze vdekjeprurëse?

Si ankohet për mungesë të energjisë, të ushqimit dhe të ndotjes së ambientit, pastaj shpenzon gjithë parat e saj për ta shkatërruar energjinë, për të mbaruar ushqimin, për të ndotur ambientin dhe prodhon tmerr, uri, lakuriqësi dhe vdekje për veten dhe për njerëzit?

A është kjo botë e çmendur?!!

Nuk e besoj, sepse ajo prodhon argumente, arsytetime dhe logjikime për çdo gjë që bën. Përpara se të vrasë, prodhon teorinë e vrasjes... përpara se të shemb e të shkatërrojë nxjerr justifikimet, arsytimet dhe përligjësimet.

Derisa edhe gjërat e pakonceptueshme i shikojmë t'i veshë me shkaqe të konceptueshme dhe rroba të imagjinueshme. Ajo gjithmonë është kriminelin dhe viktimin në të njëjtën kohë.

Ajo është gjahtari dhe preja, fajtori dhe viktimin.

A është ky mister?

Allahu na ndihmon neve të kup-



tojmë këtë mister duke na thënë se Ai e ka krijuar qenien njerëzore të aftë për çdo gjendje dhe situatë të lartë dhe të ulët. Ajo mund t'i afrohet mashtrimit djallëzor dhe mund të ngjitet në pastërtinë engjëllore.

Ajo gjithnjë është vend i përlyerës dhe i trazimit.

Nuk ka stabilitet, përveç qeniet e pejgamberëve dhe të singertëve.

Vetëm të dërguarit na e kanë vizatuar rrugën.

Ata dhe të gjithë të tjerët që kanë ecur në hapat e tyre, ata janë grupi i shpëtuar... të tjerët janë drutë e zjarrit... bile të tjerët janë në zjarr që tani dhe ata janë shumica dhe pjesa më e madhe.

Ata, që tani janë në vatrën e konflikteve dhe furrën e luftërave.

Ata janë në zjarrin e mosmarrëveshjeve, përleshjeve dhe konflikteve. Ata janë vërtetë në zjarrin e shpirtrave të tyre, pompojnë urrejtje dhe ndezin trazira.

Ata janë të verbrit e dynjasë dhe ata nesër do të jenë të verbrit e ahiretit.

"Kush ka qenë në këtë (botë) i verbër ai në ahiret do të jetë i verbër dhe më i humbur". (Isra: 72).

Ajo që po ndodh tani në këtë botë është provim, rezultati i të cilit është i ditur dhe i njohur me shenja dhe simbole që sot... banorët e zjarrit nesër, ata janë banorët e saj sot.

A ke filluar ta kuptosh?

Shiko në veten tënde dhe do ta dish se cilës pjesë do t'i takosh. Me sasinë e paqes, të cilën e ke në veten tënde do të jesh prej grupit të shpëtuar. Dhe me sasinë e irritimit, mashtrimit, urrejtjes dhe epshit të shkatërrimit do të jesh prej grupit të shkatërruar. Të mos të të mashtrojnë afishet dhe flamujt e ngritur, thirrjet dhe fjalimet, sepse sa e sa myslimanë ka që janë të tillë me pasaportë e ata janë më mohues se sa Ebu Xhehli.

Nijetet dhe veprat, ato janë njerëzit.

Ndërsa qeniet, të cilat përpiqemi t'i fshehim ato janë realiteti ynë dhe jo çfarë veshim prej rrobave dhe çfarë themi prej fjalëve.

Shiko brenda vetes, mendo, medito dhe kuptoje se çfarë fsheh në të dhe do ta dish se ku e ke vendin në këtë botë dhe ku është vendi yt në botën tjetër.

*Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja*

CEREMONIA E PËRFUNDIMIT TË KURSIT FETAR, NIVELI I PARË NË XHAMINË E FSHATIT GOLEM



Më datën 16 Nëntor 2013, në xhaminë e Golemit u zhvillua ceremonia e mbylljes së kursit fetar, niveli i parë, duke shpërndarë 25 çertifikata dhe dhurata për secilin nxënës të suksesshëm.

Kjo ceremoni vjen pas ecurisë së suksesshme të procesit mësimor dhe përfundimit të programit përkatës.

Vlen të përmendet se gjatë kursit fetar janë organizuar veprimtari fetare nga ana e sektorit të arsimit dhe nga vetë mësuesi fetar, z. Kujtim Cufaj si konkurse fetare brenda llojit dhe me paralet e kurseve të tjera, pikniqe, eskursionë, lojra sportive etj, më qëllim për të afruar larmi njohurish, njohje vëllazërore, argëtime të larmishme etj.

Në këtë ceremoni morën pjesë besimtarë të kësaj zone dhe nxënës të niveleve të ndryshme të kurseve që zhvillohen pranë xhamisë Golem. Gjithashtu mori pjesë edhe përgjegjësi dhe inspektori i arsimit, pranë Myftinisë, teologu Arben Halluni, i cili në fjalën e tij vlerësoi punën e madhe që ka bërë mësuesi e mësimbesimit në çështjen e mësimdhënies të këtyre nxënësve sipas programit të Myftinisë dhe në fund i uroi nxënësve të certifikuar suksese të mëtejshme.

25 nxënësit e çertifikuar janë: Mateo Celiku, Saed Uruçi, Eda Hoxha, Brisilda Stena, Elda Vulaj, Arsen Guri, Sara Bushaj, Kledisa Halili, Isira Manushi, Denada Bushaj, Erinda Halili, Arsid Temja, Ersi Isufi, Myslim Guri, Rihad Uruçi, Ervis Hasaj, Griselda Dushaj, Adelina Hasaj, Sabian Celiku, Gazmend Lisaj, Erisa Halili, Mirsad Guri, Gilmonda Buhaj, Eneda Baculi dhe Arsen Midili.

MYFTIU ME IMAMËT: “TË VAZHDOJMË RRUGËN E SHËRBIMIT NDAJ THIRRJES ISLAME”

Paraditen e së martës, më 3 dhjetor 2013, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka zhvilluar një takim pune me një grup imamësh të Myftinisë Shkodër. Në qendër të këtij takimi kanë qenë disa çështje, që lidhen me zhvillimin e aktivitetit fetar në Shkodër, rolin që duhet të kenë imamët në mbrojtjen e interesave të fesë dhe zhvillimin e mëtejshëm të mësimëve të saj në kontakt të përditshëm me njerëzit etj.

Fillimisht Myftiu ka bërë një prezantim të realiteteve shqiptare dhe shtimin e shenjave të islamofobisë, si një shenjë aspak e mirë për integrimin e Shqipërisë në nivelin e vendeve dhe kombeve të lira, që respektojnë besimin, fenë dhe vlerat e njerëzve të lirë e të vetëdijshëm për kontributet që i detyrohen vendit, shoqërisë, besimit.

Myftiu ka kërkuar nga imamët që të jenë të vëmendshëm dhe të mos tolerojnë asnjëri që përpiqet të prishë rendin e traditave fetare, ndryshimin e tyre a varfërimin e jetës së xhamisë, nëpërmjet bidateve të reja në emër të synetit, dijes a leximeve spontane.

Në këtë takim është diskutuar edhe mbi domosdoshmërinë e studimit të gjurmëve të muslimanëve në ndërtimin e Shqipërisë, leximin e duhur të pavarësisë dhe mosnënshtrimin ndaj thirrjeve shterpë të kujtdo që vendos një shenjë barazie në mes të integritit të vendit tonë me ndryshimin e identitetit fetar.

Në takim është folur edhe për abonimet e reja vjetore në revistën "Drita Islame" dhe "Zani i Naltë", si dy revista cilësore, që pasurojnë ditë pas dite jetën intelektuale dhe fetare të lexuesve muslimanë shqiptarë, por jo vetëm.

Myftiu ka lajmëruar se ditën e xhuma, më 6 dhjetor 2013, në ora: 17.00, në kinema "Millenium", do të transmetohet dokumentari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, me rastin e 90 vjetorit të revistës "Zani i Naltë".

Në fund të këtij takimi, për imamët e pranishëm është bërë shpërndarja e librit më të ri nga Imam Didmar Faja, Prijës i Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane në Arizona të ShBA, "Shprehi dhuntitë e Zotit tënd".



MYFTIU BËN THIRRJE PËR RIKTHIMIN E MËSIM-BESIMIT NË SHKOLLAT E VENDIT

Ditën e enjte, më 5 dhjetor 2013, nëpërmjet një komunikimi për mediat, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka ripërsëritur kërkesën e tij për kthimin e lëndës së mësim-besimit në shkollat publike të Shqipërisë.

Kjo deklaratë ka ardhur një ditë pas vrasjes së dhimbshme në një prej shkollave të Shkozetit, kur një adoleshent vrau me armë zjarri një bashkëmoshatar të tij.

Në deklaratën e tij para mediave të pranishme, Myftiu ka theksuar se ka ardhur koha që lënda e mësim-besimit të rikthehet në shkollat e vendit, pasi u hoq në mënyrë arbitrare kohë më parë. "Në këtë mënyrë, do të vërtetohet plotësisht ndarja nga sistemi ateist, që shkatërroi xhamitë dhe objektet e kultit dhe hoqi lëndën e mësim-besimit nga shkollat" - ka vijuar Myftiu.

Myftiu ka konfirmuar se lënda e besimit në shkollat e vendit, do të ndikojë në zbutjen e fenomeneve negative dhe do të bëhet shkak në edukimin e fëmijëve me besimin në Zot dhe moralin e fesë.

Kërkesa për rikthimin e lëndës së mësim-besimit në shkollat e vendit, është një kërkesë e përsëritur nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në takime të ndryshme zyrtare, por edhe deklarata mediatike.

Akoma Ministria e Arsimit, nuk ka dhënë asnjë përgjigje për këtë kërkesë, që ndoshta ka ardhur koha të kërkohej në mënyrë më të intensifikuar dhe në një lëvizje kombëtare, për çdo myftini e për çdo qytet, duke sensibilizuar besimtarët drejt kësaj domosdoshmërie, duke iu referuar edhe degradimit të brezit të ri dhe shfaqjes në masë të veprimeve ekstreme dhe imorale.

Dokumentari mbi 90 vjetorin e revistës "Zani i Naltë"...

Mbrëmjen e së xhumasë, më 6 dhjetor 2013, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zgjodhi Shkodrën si stacionin e radhës, për shfaqjen premierë të dokumentarit mbi 90 vjetorin e revistës "Zani i Naltë".

Aktiviteti që u zhvillua në kinema "Millenium", mbledhi personalitete të fesë, kulturës, drejtues lokalë, imamë, drejtues të medreseve, shoqatave islame etj.

Në këtë shfaqje premierë të dokumentarit mbi 90 vjetorin e revistës islame "Zani i Naltë", nderonte me pjesëmarrjen e tij edhe Nën/kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Gazmend Aga, Drejtori i revistës "Zani i Naltë", z. Genti Kruja, Myftiu i Lezhës, z. Erton Yzeirllari dhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj. Të pranishëm ishin edhe Kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Bardhyl Lohja dhe Drejtori i Bibliotekës së Shkodrës, z. Gjovalin Çuni.

Fillimisht, aktivitetin e ka përshëndetur Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari. Në fjalën e tij ka shprehur mirënjohjen dhe falënderimet për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe redaksinë e revistës "Zani i Naltë" për prodhimin e këtij dokumentari me vlerë, që na sjell në vëmendje kontributet e vjera të muslimanëve shqiptarë në rrugën e formësimit të identitetit kombëtar, me dije, përkushtim, qytetari e mbështetje në Zotin.

Me këtë rast, Myftiu ka bërë një homazh për hoxhallarët dhe intelektualët e shquar shkodranë, që dhanë kontributet e tyre për revistën "Zani i Naltë". Këtë vlerësim e ka shfaqur edhe në dhuratën e bërë nën/kryetarit

të KMSH, H. Gazmend Aga, polifoton e një grupi të dalluar hoxhallarësh shkodranë, me kontribute të vjera në dije. Njëkohësisht i ka dhuruar z. Genti Kruja, një faksimile të revistës "Zani i Naltë", të vitit 1938, me një shkrim të dijetarit shkodran Sheh Qazim Hoxha.

Të pranishmit i ka përshëndetur edhe Nën/Kryetari i KMSH, H. Gazmend Aga, që ka shprehur kënaqësinë e tij për interesimin e madh të besimtarëve shkodranë, të rinjve në mesin e tyre, për këtë aktivitet në nderim të një gjurme të ndritur të brezave të shkuar muslimanë, të konkretizuara në një revistë plot vlerë e udhëzim.

Nën/Kryetari Aga ka vlerësuar kontributin e hoxhallarëve dhe intelektualëve shkodranë në revistën "Zani i Naltë" dhe ka theksuar se këto gjurmë të ndritura duhen pasuar dhe çuar përpara edhe nga brezi i ri, si një amanet që na bashkon.

Drejtori i revistës "Zani i Naltë", z. Genti Kruja, në fjalën e tij përshëndetëse, ka vënë theksin te nevoja e studimit të kontributeve fetare, filozofike, sociale e kulturore në 16 vitet e para të revistës "Zani i Naltë". Ai ka theksuar se me rastin e 100 vjetorit të Shqipërisë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë mori vendimin e rimëkëmbjes së kësaj reviste me emër, duke bërë që sot, në harkun e një viti, të botohen 5 numra me materiale të bollshme, studime, analiza, biografi dijetarësh etj, që sinjalizojnë se revista po shkon në drejtimin e duhur.

Më pas, për rreth 45 minuta, të pranishmit kanë ndjekur me kureshtje dokumentarin mbi 90 vjetorin e revistës "Zani i Naltë".





Mr. Muhidin Ahmeti

Te shumica absolute e popujve të vjetër paganë, kremtimi dhe pritja e vitit të Ri nuk ishte asgjë tjetër veç se lavdërim, madhërim, simbol dhe shenjë e adhurimit të ndonjë trupi qiellor, në rastët më të shpeshta të Diellit. Kështu, në Egjiptin e vjetër, populli i të cilit, sipas Herodotit, e këtë e vërtetëon edhe Kur'ani, i shpikte emrat e hyjnive paganë, të cilët më pas i pranuan Grekët, e nëpërmjet tyre edhe popujt tjerë të Evropës..

Çdo egjiptas respektonte zotët dhe hyjneshat Isid e Oziris. Tek ata Amon-Ra, zoti i Diellit është ai që të Grekët ishte Zeusi. Herakli është njëri nga dymbëdhjetë zotët egjiptian dhe Helenasit e moren nga Egjiptasit atë emër për Herakliun e tyre. Dhe në të vërtetë emrat e gati të gjithë zotëve në Heladë erdhën nga Egjipti.

Kjo qe periudha më e theksuar e Paganizmit - besimit në shumë zotra. Zotra këta që personifikonin fenomenet natyrore përmes të cilëve ata parshikonin të ardhmen dhe ushtronin shkathtësinë e magjisë.

“Me ngulmim, në emër të Zotit, ju them: Ju s’duhet të jetoni më si paganët... Meqë nuk e njoh Perëndin dhe s’duan të dinë gjë për Të, janë të verbër për të vërtetën dhe s’kanë asnjë pjesë në jetën e vërtetë, e cila vjen nga Perëndia...” (Bibla, Efesianëve, 4:17-20)

Duke u mbështetur dhe duke pas parasysh porosinë e thënies së lart-

FESTA E VITIT TE RI DHE IDHUJTARIA E KOHËVE MODRNE

përmendur biblike, të krishterët njëmbëdhjetë shekuj paten neveri nga festimi dhe kremtimi i një Janarit të Vitit të ri si traditë pagane. Tek në shekullin e dymbëdhjetë, pas njëmbëdhjetë shekujsh mospranimi të datave të Vitit të Ri nga popujt e Evropes, Kisha e pranoi via facti një janarin për fillimin e vitit diellor. Pranimi, festimi dhe shënimi fetar i Vitit të Ri kundër të cilit Krishtërimi luftoi pamëshirshëm njëmbëdhjetë shekuj me radhë nuk është asgjë tjetër veç se një argument i pakontestueshëm që Kisha nuk arriti asnjëherë të kristianizojë Evropën, veç përkundrazi Evropa paganizoi krishtërimin.

Festimi dhe kremtimi i Vitit të ri - Një Janari - jo vetëm që për nga origjina është ceremoni pagane, por edhe për nga forma dhe mënyrat se si festohet në ditët tona paraqet një formë të veçantë të idhujtarisë.

Duke e shikuar këtë në prizmin e aktualitetit shqiptar, festimi, kremtimi, ceremonia, blerjet jonormale, orgjitë, ndejat e shfrenuara me pije alkoolike, kallapitjet, përçafimet, fishekzjarrët, të shtënat me pushkë, shpërthimet ekspolduese, thyerje xhamash, shkatërrim banesash, shtëpish, automobilash, rrezikim psasurie, sigurie e jete, pasardhësish, prishje e rendit publik dhe e qetësisë së qytetarëve, pritje të përbashkëta zhurmëmëdha të Vitit të Ri, urimet dhe programet speciale me muzikë e këngë që bëjnë të vallzojë gjaku vetë duke bërë spastrimin e trurit, nuk janë asgjë tjetër, veç se vazhdim i tarditës, riteve, dhe zakoneve të vjetra pagane e idolatorike të Egjiptasëve të vjetër dhe Romakëve për nder të hyjneshës Izia dhe Hyut Janus.

Këto janë disa veçori që karakteri-

zojnë kremntimin e festave në ditët tona që për dallim nga festat klasike, pagane këto të sotmet janë të organizuara më mirë, me mjete më të përparuara e më të sofistikuara. Sa për ilustrim po sjellim një shembul nga bota e insekteve, më saktësisht nga termitet. Të gjitha format e përmendura të manifestimit të kënaqësive para dhe gjatë ditës së Janusit, Izidës apo diellit, na përkujtojnë ditën



e vetvrasjes kolektive në dasmën njëherë në vit kur të gjithë termitet mundohen të dalin e të paraqiten në diellin e ditës së dasmës. Me atë rast ata nuk janë të vetedijshëm se dalja e tyre në diell do të thotë vdekje e pamëshirshme. Mbijetojnë vetëm ata termit, të cilët rojet i mbajnë brenda në fole për përtëritjen dhe ekzistencën e llojit.

E njëjta gjë nodh edhe me njerëzit natën dhe ditën e vitit të Ri. Njerëzit mashtrohen kur mendojnë se me vitin e vjetër mbetet çdo gjë e vjetër, në radhë të parë shpresat e pare-

alizuara, ndërsa viti i ri si çdo gjë e re do t'i përmbushë dëshirat dhe ëndërrat. Me ndërrimin e moteve nuk ndryshon koha, nuk ndryshojn gjërat vetvetium as nuk transformohet njeriu brenda natës. Ç' është, pra koha e cila vazhdimisht na sjell Vitin e ri? Vallë, a është koha diçka tjetër përveç se sot, dje dhe neser? Ajo shkon dhe kthehet te ne duke na dhënë herë natën herë ditën. Nuk kalon koha, kalojmë ne. Pyesim: "Sa netë e ditë të njëjta kanë kaluar ndër shqiptarët dhe sa jetë e fate njerëzish kanë marrë me vete? Sa shqiptarë e shqiptare kanë kaluar nëpër netët e gjata të së kaluares sonë kombëtare, duke



u ndërruar breza të tërë së bashku me vitet e rinj, e megjithatë realiteti ynë është ai që është. Përse vallë, t'i festojmë vitet e rinj kur gjithmonë na përseritet e njëjta histori, epigonike dhe paganike. Është thënie e vërtetë se "historia përsëritet vetëm se me gabime më të mëdha." Profeti i Zotit -Muhammedi (s) tha: "*Mos lejoni t'ju kafshojë gjarpëri dy herë në të njëjtin vend.*" Kombin shqiptar, gjarpërinjt e tij historik shumë herë e kanë kafshuar dhe shumë plagë i kanë shkaktuar, megjithatë ai vazhdimisht i ka imituar, vazhdon edhe sot t'i imitojë po ata të njëjtët popuj

si nga pikëpamje ideologjike ashtu edhe kulturologjike. E dëshmi për këtë është që edhe sot pas dy mijë vjetësh historie, ai kërkon rrënjët e identitetit të tij. Këtë e bëjnë një pjesë e madhe e inteligjencies shqiptare nga të gjitha trojet. Përse? Sepse nga mungesa e strukturës shpirtërore dhe defektologjive strukturore në qenien e elitës shqiptare, kombi shqiptar si nga pikëpamja ideologjike ashtu edhe kulturologjike ka mbetur pa "kible të qartë". Ndonëse edhe rrënjët edhe Kibla e shqiptarëve është e qartë si drita e diellit, gjeniu shqiptar për dy mijë vjet me radhë është përpjekur të gjejë rrënjë dhe të bëjë kible artificiale. Prandaj, shumë defekte në strukturën e ADN-ës sonë janë trashëguar me dekada e shekuj duke na sjell vazhdimisht vitet e rinj me histori të vjetra epigonike e paganike.. Çfarë do të thotë një Fillim i Ri pa reflektim?!

Për çdo vit të Ri e njëjta histori. Përse? Seps Viti i Ri nuk e ndërron historinë, njerëzit janë që e bëjnë historinë. Mirëpo, te ne është e kundërta. Historia na bën ne. Prandaj, një pyetje tjetër do të ishte: Si të festojmë vitin e ri me njerëz të vjetër me ide e mentalitet të vjetër. Dikush do të përgjigjej se nuk janë më ato kohëra kur është festuar Vitit i Ri për nder të atyre idhujve e zotëve të rrejshëm.

Vërtet nuk janë më ato kohëra, por nuk janë më as ata njerëz. Dikur kanë qenë ata magjistarët e thjeshtë që kanë gënjyer dhe kanë mashtruar popullin. Sot janë mjeshtra të dëshmuar dhe specialistë të magjisë (nuk është fjala për Koperfeldin), por për regjisorët televiziv, pushtetarët dhe të tjerë, taman mjeshta të gënjeshtres, manipulimit, mashtrimit, vegimit, iluzionit. Përmes pushtetit politik dhe mediatik, magjistarët e sotëm përpiqen t'i magjepsin shpirtërat, trurin, zemrën, veshët dhe sytë e njerëzve.

Nga aspekti i cilësdo fe monoteiste

e në mnyrë të veçantë nga pikëpamja e fesë islame, festa e Një dhe Dy Janarit në krahasim me Zotin është shirk - idhujtari, glorifikim dhe madhërim i hynive mitike - pagane të Izidës e Janusit dhe të madhëruarit e treguesëve të Diellit (Solistici i diellit ose vitin e vjetër të silvesterit në vend të Krijuesit).

Ndër format e krenimit të festave, përveç tjerash dominon edhe shundi në TV-e, i cili transmeton në rastet më të shpeshta mallin më të lirë, mallin dhe mbeturinat e kuturave të huaja nga të cilat vetë vendët e zhvilluara duan sa më parë të lirohen. Trasmethohen filma dhe programe e spektakle televizive pa vlera artistike, vetëm për t'i kënaqur tekat e atyre njerëzve, të cilët janë të pandjeshëm dhe indiferentë ndaj vlerave të kulturës së vëretë. Njerëz, në mënyrë të veçantë intelektualë që janë të prirur për kiç dhe që kurr nuk do të futen në botën e shpirtit, frymës, kulturës, artit dhe bukurisë, sepse vakuumin e brendshëm dhe nihilizmin e kompensojnë me lavdi dhe shkelqim të jashtëm. Njerëz që vuajnë nga snobizmi që për synim kanë imitim e të huajve dhe mohimin e identitetit dhe vlerave personale. Njerëz pa koncept të qartë në jetë dhe pa vizion për të ardhmën.

Pavarësisht nga përgjigjet e shumta që janë dhënë në lidhje me traditën, zakonet mitologjike - pagane egjiptiano-romake me rastin e krenimit të Vitit të Ri, mendimin dhe përgjigjen islame e ka dhënë Jusufi (a.s.), atëherë kur në burg si rob i shitur dhe i huaj u tha bashkëvuajtsëve të tij: "*Unë me të vëretë nuk kam asgjë të përbashkët me fenë e atij populli që nuk e beson All-llahun dhe që mohon Botën tjetër. Unë ndjek fenë e të parëve të mij, Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit. Neve nuk na ka hije t'i bëjmë shok All-llahut! Kjo është një mirësi që na dhuroi Zoti ne dhe të gjithë njerëzve, por shumica e njerëzve nuk janë mirënjohës. O shokët e mij të*

burgut, a është më mirë të adhurohen gjithfarë zotësh apo All-llahu, i Vetmi Ngadhënjimtar?! Ata që i adhuroni në vend të All-llahut janë vetëm emra më të cilët ju dhe prindërit tuaj i pagëzuar ata. All-llahu nuk ka shpallë kurrfarë faktësh për ta, ndërsa gjykimi i fundit i takon vetëm All-lahut! Ai ka urdhëruar të mos adhuroni askë përveç Atij. Ajo është e vtemja fe e drejtë, por shumica e njerëzve nuk dinë.” (Jusuf, 37-40).

Nga ky ajet kuptojmë se rëndësia e totemeve të djeshëm nuk ishte në format e tyre, peshën apo materialin nga i cili ishin gdhendur dhe skalitur, veç se e vetmja “vlerë” e tyre ishte në kuptimet që njerëzit u kishin dhënë atyre. Dëshmitari i Lartësuar pa asnjë hezitim demaskon psikologjinë e fshehur pas idhujtarisë së përmendur, duke vënë në pah se idhujtarët, në të vërtetë, janë vetëm adhuruesë të emrave, kuptimeve dhe definicioneve që ata vetë ua kishin dhënë fenomeneve dhe objekteve të prekshme pa pasur për ta ndonjë argument valid. Kështu që përlësia dhe frikrespekti i tyre para statujzave jokarizmatike me formë të shëmtuar është rezultat i drejtpërdrejtë i iluzionit që ideologjikisht vetë e kanë përpunuar. Idhujtarët modernë me mutacion janë shndërruar në forma të ndryshme, por ata mbeten tërësisht viktimë e të njëjtit gabim. Qoftë fjala për frikën nga njerëzit, funksioneve titujve apo uniformave të të cilëve u kanë dhënë tërësisht statusin e pamerituar dhe janë bërë skllëvër të kuptimeve që i kanë gjetur apo edhe vetë ua kanë dhënë atyre. Apo është fjala për fobi të ndryshme për shkak të cilave u dridhën gjunjë, u ngushtohen zemrat dhe për shkak të cilave ndjehen si qyqarë dhe të pafatë, duke mos e ditur se ato janë frika fantazmë të cilat do të shkriheshin vetëm nëse marshojnë me guxim drejt tyre dhe i definojnë më realisht ato.

Në idhujtarinë e kohëve moderne bëjnë pjesë edhe kultet e persona-



litetit apo riciklimi i autoriteteve të rrejtshëm/të konsumuar, të cilët i shfrytëzojnë titujt e tyre akademik dhe sufikse dhe prefikse të tjera arbitrare rreth emrave të tyre si rekuizite praktike nga arsenali i tyre i pasur hipnotik përmes të cilit legalizojnë pushtetin dhe forcën e tyre mbi shoqëritë sugjестive muslimane.

Më i rrezikshëm se adhurimi i putave dhe idhujve është prodhimi i tyre. Më i rrezikshëm se prodhimi i autoritetëve të konsumuar është riciklimi i tyre, ndërsa rinia e pastër, e arsimuar, e edukuar dhe e pakompromentuar ose e pret zhdukjen e tyre biologjike ose në padurimin e tyre pranojnë të jenë baza e tyre zgjedhore. Autoritetet e tilla të rrejtshme (gazetër të konsumuar, intelektualët servilë, liderët e konsumuar fetaro-politik) të kohës sonë kërkojnë të njëjtin trajtim çfarë i bëri Ibrahim (a.s.) idhujve të kohës së vet, e ai është të theksuarit e qartë të pafuqisë dhe paaftësisë së tyre për të evituar çfarëdo të keqe kolektive ose për të siguruar ndonjë dobi kolektive. Me siguri që reagimi ndaj një qasjeje të tillë do të shkaktonte forma të ndryshme të ndjekjeve të inskenuara dhe hedhjes në turrën

e druve (stavë). Mirëpo, All-llahu (xh. sh.) na ka mësuar në Kur'an që zjarrët, në të cilat shoqëria apatike i hedh kryengritësit (rebeluesit), shikuar në perspektivë (në planin afatgjatë), janë me arsye zjarre të ftohta dhe shpëtimtare.

- Ky artikull është botuar edhe në vitet e mëparshme, por këtë vit ka pësuar disa ndryshme, jo substanciale, por komplementare.

Refrencat:

1. Kur'ani – përkthimi i kuptimeve të Kur'anit nga Besim Korkut – marrë nga: www.islamhouse.com/ dhe “Die Botschaft des Koran” nga Muhammad Asad, übersetzung und Kommentar, 2009 Düsseldorf.

2. Die Bibel, Psalmen und Neues Testament Ökumenischer Text, 1980 Katholische Bibelanstalt Stuttgart und Österreichisches Kaktholisches Bibelwerk Klosterneuburg.

3. Mustafa Spahiq, “Liljan” gazetë boshnjake e para dhe gjatë luftes...

4. Edin Tule, Mentalni parkour, Sarjevo, 2013 (libri është në përkthim e sipër).

5. www.feqiir.informe.com

NIS RRETHIMI I VAKËFIT PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË LAGJEN DUDAS

Pas një pritje 23 vjeçare, duket se edhe për lagjen Dudas është shfaqur një rreze shprese në rrugën e ndërtimit të një xhamie të munguar për këtë lagje muslimane, prej së cilës kanë dalë hoxhallarë të nderuar, që i kanë shërbyer me shumë përkushtim harmonisë së besimit në Shkodër.

Ditën e shtunë, më 7 dhjetor 2013, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin "Mirësia", ka nisur rrethimin e territorit, ku është planifikuar të ndërtohet xhamia e re e lagjes Dudas. Njëkohësisht është bërë edhe përcaktimi i drejtimit të kibles, mbi bazën e së cilës do të vijojnë edhe punimet për hapjen e themeleve dhe përgatitjen për ceremoninë e hedhjes së gurit të themelit.

I pranishëm në nisjen e këtyre punimeve ka qenë Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed sytari, si dhe Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja.

Fillimisht Myftiu ka shprehur kënaqësinë e tij për këtë mirësi të madhe të Zotit, që po mundëson pasurimin e lagjes Dudas me një xhami të re, që do të zbukurojë edhe më shumë hartën e xhamive dhe minareve të bardha në qytetin e Shkodrës.

Myftiu ka falënderuar drejtorin e Fondacionit "Mirësia" për praninë e tij në këtë fillim të punimeve, duke shprehur njëkohësisht vlerësimin e tij për bashkëpunimin dypalësh në projekte të dobishme për ripërtëritjen e infrastrukturës fetare në qytetin e Shkodrës, nëpërmjet ndërtimit të xhamive.

Me mbarësinë e All-llahut, brenda pak ditësh, pritet të zhvillohet edhe ceremonia e hedhjes së themeleve për xhaminë e re të lagjes Dudas.

MYFTINIA SHKODËR NDIHMON 40 FAMILJE JETIMËSH NË EKSTREMIN E SKAMJES

Paraditën e së hënës, më 9 dhjetor 2013, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Shërbim Social, ka bërë shpërndarjen e 40 pakove ushqimore për familje të jetimëve mbi moshën 18 vjeç, që strehohen në konvikte të ndryshme të qytetit Shkodër.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari së bashku me drejtoreshën e ZRShS Shkodër, Valbona Tula, kanë vizituar disa prej këtyre familjeve duke parë nga afër gjendjen e mjerueshme të tyre, që jetojnë në kushtet më ekstreme të mjerimit, varfërisë, skamjes dhe mungesës së përkrahjes.

Në një deklaratë për mediat, Imam Muhamed Sytari ka bërë apel që pushtetarët, biznesmenët dhe njerëzit vullnetmirë, të sjellin sytë e tyre nga kjo shtresë njerëzish në nevojë, për ta ndryshuar sadopak realitetin e zyrtë, në të cilin ata jetojnë. Myftiu ka theksuar se ndihmat e sotme janë njëkohësisht edhe një thirrje e

sinqertë për të ndihmuar këta njerëz, që janë dëshmia më e keqe e varfëritetit shpirtëror dhe neglizhencës ndaj njerëzve në skamje në vendin tonë.

“Realitete si këto ku jetojnë këta njerëz dhe aspiratat drejt integritetit evropian, janë në disekuilibër dhe njëkohësisht një njollë e zyrtë në prezantimin tonë para botës. Me kësi realitetesh, nuk ka sesi të pretendojmë t'i bashkohemi bashkësisht së popujve të qytetëruar, solidarë me nevojtarin dhe dhimbjen e tij” – ka thënë Myftiu.

Nga ana e saj drejtoresha e ZRShS Shkodër, Valbona Tula, ka falënderuar bashkëpunimin me Myftininë Shkodër dhe gatishmërinë e saj për të ndihmuar këtë shtresë njerëzish në nevojë.

Myftinia Shkodër falënderon në veçanti xhematin e xhumasë në xhaminë e Parrucës, të cilët patën mirësinë t'i përgjigjen thirrjes së Myftiut për të kontribuar për njerëzit në nevojë dhe projektet e ndryshme bamirëse të Myftinisë Shkodër.



NË EMËR TË FËMIJËVE TË MI...

*Tymi i luftës më mbuloi,
dola gjallë, eci përsëri...
Si buzëqeshje – ngrohtësi nëne
u fali dy bijve të mi...*

*Shamia e rënë përmbi supe
si hënë e zbehtë më shoqëroi...
Dy zemra dridhen si gjethe vjeshte,
me qiellin-zemër i mbuloi...*

*Ecim dhe ecim pa ditur ku?..
Buza dhe loti më janë tharë...
Pas vetes mbart dy ëndrra-jetë,
tokën ku linda e puth me mall...*

*Ecim dhe ecim, e tym'i luftës
pas na ndjek si kos'e vdekjes,
Shpirti më thotë: - O bijtë e mi!
Ëndrrat që kemi ia falim Jetës!..*

*Tmerret e luftës, tymin e vdekjes,
s'dua ta shohin f'mijët e mi,
i kam gdhendur në f'tyrën time,
si Testament e si Dëshmi...*

Xhahid Bushati, shkrimtar

- monologu i një nëne siriane -

Anekdotë...

Sorrën dhe bilbilin i mbylli në kafaz një zullumqar
 Sorra i tha bilbilit: “Kush nga ne këndon më bukur o xhanëm këngëtar?
 Si thua o zëëmbël, e bëjmë dot bashkë një garë?
 “Mos aman!” – i tha bilbili – “se s’jemi nga e njëjta farë,
 Këngët i kemi të ndryshme, e si mund të futemi në garë?”
 “Epo, do këndosh se s’bën” – i tha sorra këmbëngulësisht
 Meqë jemi mbyllur këtu, do garojmë miqësisht,
 “Krreu” – bëri sorra disa herë dhe i tha bilbilit të mjerë:
 “Hajt, fillo ti tani të të dëgjoj një herë!”
 Nga zori i gjori zërin e ëmbël nxori,
 “Ah medet bilbil, vdekja që s’të mori!”
 “Të thashë që unë këndoj më bukur” i tha sorra bindshmërisht
 Po s’besove, e pyesim dikë që do gjykojë paanshmërisht,
 Pranë kafazit rrinte një gomar dhe pëlliste me zë të lartë
 “Ta pyesim gomarin” - tha sorra – “se ky ka veshë të gjatë”
 Cili këndojmë më bukur, unë apo ky bilbil këngëtar
 “Bukur ia thotë bilbili, por ty moj sorrë s’ta kalon dot” – tha gomari
 “Ke të drejtë” – tha zëëmbëli – “kështu ka qenë gjithmonë,
 Te tjetri e pëlqejmë atë që është si te vetja jonë”.

Fatmir Muja

(Botohet me autorizim të autorit)

“KAM UZDAJË SE ZOTI KA ME E KTHY KTE POPULL”...

Dita e sotme, një ditë e zakonshme pune, në limitet e një të tretës së parë të këtij muaji në fund-vit, u pasurua nga takimi i përzemërt me një plak të mirë e të urtë në fshatin Barbullush. Është mirësi e Zotit, kur takohesh me njerëz, në sytë e të cilëve bashkohet bardhësia e viteve, drita e besimit dhe bekimet e ditëve, që pasurohen e bukurinë e ndjekjes së xhamisë së re që hedh shtat, me mbarësinë e All-llahut...

Dita e sotme, një ditë e zakonitë dhjetori, e ftohtë, por e përzier me rreze dielli, që vendos ekuilibër në

natyrën e bukur të Shkodërloces, u zbukurua dhe mori kuptim nga fjalët e singerta dhe lutjet e natyrshme të plakut të mirë 92 vjeçar, z. Ragip Arifi, i cili për asnjë moment nuk heq dorë nga shpresa e tij, teksa përsërit: “Kam uzdajë se Zoti ka me e kthy kte popull”...

Dhe teksa plaku me fytyrën e lëmuar e të dritshme, si drita e rrezeve të diellit që hynin në xhami, nëpërmjet dritareve të hapura, mbështetej në bastunin e tij besnik, mirësia e shpresës dhe uzdajës së tij, i jepnin ngjyrë bekimesh takimit tonë...

Dhe, e vërteta është si thotë plaku i moçëm! E vërteta është se populli im ka rrëshqitur prej dekadash, jo nga dëshira e tij, sesa nga hilet dhe hijet e tyre, që jo pak herë e kanë rrethuar botën e tij... Jo nga dëshira e natyrshme, sesa nga mashtrimi i madh, në ujrat e të cilit vazhdon të lëvrojë prej dekadash të zymta varfëruese, i hutuar, pa e ditur se drejt cilës humnerë a cilit labirinth po tërhiqet nga rrymat e hiles dhe hijeve të saj të vitpërvitshme...

Por, populli im e ka përherë një uzdajë kthimi, tamam si uzdaja, në të cilën shpreson plaku me bastun, i mbështetur për mur të xhamisë, bri rrezeve të diellit ngrohës... E ka një mundësi me u kthy nga Zoti, me kërkim falje e me ndjekje udhën e baballarëve me abdest në zemër e tespihë në dorë, me vullnetin e punës dhe ambicien e fitimit hallall" Ka shembullin e nënave pastërtore, me buzagaz e duararta, që lindën burra të ndershëm e ndërtuan vlera në botën tonë" Ata, të mbështetur në Krijuesin e tyre, jetuan në paqe e harmoni me Zotin, me veten, tjetrin e natyrën"

E ka një mundësi, që fëmijët e tij të rriten me bardhësinë e besimit dhe urtinë e udhëzimit drejt dashnisë së Zotit, i cili pret ditë pas dite, ata që shpresojnë në uzdajën e kthimit drejt Derës së Tij"

E, teksa ndahesha nga plaku fytyrëqeshur, nëpërmjet dritës së syve të tij, dukej se edhe horizonti dëshmonte uratën e tij të kësaj dite dhjetori: “Kam uzdajë se Zoti ka me e kthy kte popull”...

Shkodër, më 10 dhjetor 2013

Imam Muhamed Sytari



MYFTIU: “XHAMITË JANË VARFËRUAR NGA MUNGESA E MEXHLISEVE TË DHIKRIT!”

Ditën e xhuma, më 13 dhjetor 2013, nëpërmjet minberit të xhamisë së Parrucës, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka bërë thirrje për kthim nga dhikri, si mundësia më e mirë për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shfaqjes së individit musliman në jetën e përditshme.

Gjatë hytbes së tij, Myftiu ka përmendur se prej kohësh mendime dhe ideologji të ndryshme të prodhuara nga jomuslimanët, po prekin thelbin e Islamit, duke bërë që në mesin e besimtarëve të hyjë dyshimi, injoranca dhe fryma e përçarjes.

Myftiu ka kritikuar modelet e reja të disa personave që shfaqen nëpër xhami, duke mos kryer synetet, duke u larguar nga viridet e dhikrit e duke tërhequr pas vete edhe besimtarë të rinj, që gënjehen pas shfaqjeve të jashtme të këtyre personave.

“Në fakt, po të vështrojmë me vëmendje, do të gjejmë se urdhëri më i spikatur në Kur’an është ai për të përmendur All-llahun; dhikri, si thelbi i besimit dhe fesë islame. Sepse All-llahu do që ne të jemi eulijatë e Tij, të mbrojtur e të udhëzuar prej Tij në çdo moment të jetës. Ndërsa, ajo që shohim kohët e fundit është varfërimi i xhamive nga mungesa e

mexhliseve të dhikrit, dalja në skenë e një fryme injorante që hedh balte mbi dijetarët dhe eulijatë e mëdhenj të botës tonë, që na e mësuan dhikrin dhe dashninë e All-llahut, si: Sejjidi Ahmed Er-Rifai, Imam Gazali, Imam Ibn Tejmije, nxënësi i tij Ibnul-Kajjim, Ebu Hanife, Imam Neveviu etj. Kjo përbaltje u forcua edhe nga injoranca e madhe e shfaqur në shumë prej pasuesve dhe drejtuesve të paditur të tarikateve islame, që prodhuan modele të devijuara, që njollosin jo vetëm fenë islame, por edhe dijen dhe dijetarët. Por, ky fenomen, nuk na ndalon që të ringjallim traditat e kthimit nga dhikri, duke u frymëzuar nga ajetet kur’anore dhe hadithet profetike. Individit musliman, duhet të ketë një murshid në jetën e tij, një prijës, një imam, prej të cilët të mësojë fenë, dashninë, dhikrin, ashtu si na e ka mësuar profeti (a.s), sahabët dhe pasuesit e tyre brez pas brezi.” - ka thënë Myftiu.

Gjatë hytbes, Myftiu i është referuar ajeteve dhe haditheve të ndryshme që nxisin dhikrin dhe shpjegojnë mirësinë e madhe, me të cilën All-llahu e ka veçuar ymetin islam nga ymetet e tjera, duke e bërë dhikrin udhërrëfyes për jetën e muslimanit.



“Nana,
është njeriu
i vetëm që mund
të harrojë
të bëjë dua
për veten e saj
në namaz,
sepse është
e zënë me lutje
për fëmijët
e saj!”



Amr Khalid

Myftiu pret nipin e Hoxhës së nderuar H. H. Jusuf Këlmendi (1876-1943)



Paraditën e së mërkures, më 18 dhjetor 2013, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka pritur në një takim të përzemërt, z. Qazim Meti, nip i Hoxhës së vjetëre të nderuar shkodran, Haxhi Hafiz Jusuf Këlmendi (1876-1943).

Fillimisht Myftiu ka shprehur kënaqësinë e tij për këtë takim të parë me nipin e njërit prej hoxhallarëve elitari të Shkodrës, të cilët kanë lënë gjurmë të vyera në shërbim të fesë, trashëgimisë së dijes brez pas brezi, si dhe shërbimeve ndaj vlerave të kalifatit Osman, në ditët e të cilit ai ka jetuar për 36 vjet.

Myftiu ka rrëfyer lidhjen e tij shpirtërore me H. H. Jusuf Këlmendin, që ishte njëkohësisht edhe Hoxha dhe muxhizi i H. H. Sulejman Gavoçit, i ati dhe Hoxha i dijetarit të shquar shkodran H.H. Vehbi S. Gavoçi.

Nga ana e tij, z. Qazim Meti ka vlerësuar punën e Myftinisë Shkodër dhe vlerësimet e ndryshme për gjyshin e tij, duke e vlerësuar si një personalitet të shquar islam të qytetit Shkodër dhe përtej saj.

Z. Meti ka rrëfyer edhe disa kujtime nga gjyshi i tij, H. H. Jusuf Këlmendi (1876-1943), duke spikatur madhështinë e bibliotekës së tij dhe interesimin e hoxhallarëve të Shkodrës për të blerë e marrë nga këta libra pas ndërrimit jetë të Hoxhës. Ai

ka shprehur edhe dhimbjen e madhe për faktin se kjo bibliotekë u zaptua dhe u vodh nga të pafetë komunistë, të cilët u përpoqën të fshijnë të gjitha gjurmët e dijes dhe besimit islam në këtë vend.

Gjatë këtij takimi është folur edhe për gjurmët e ndryshme diturore të Hoxhës së nderuar H. H. Jusuf Këlmendi (1876-1943), edhe si autor i librit me pesë ilahi në shqip me alfabet arab.

PROMOVOHET LIBRI "NÚN PASHA LAPSIN"

Mbrëmjen e së enjtes, më 26 dhjetor 2013, në një atmosferë miqësore, në mesin e një rrethi të ngushtë me familjarë, miq, shokë, dashamirë e kolegë të Myftiut të Shkodrës Imam Muhamed Sytari, është zhvilluar promovimi i librit të tij më të ri me titull: "Nún Pasha Lapsin".

Në analizën e librit, shkrimtari Xhahid Bushati ka nxjerrë në pah rëndësinë e shkrimit, sidomos në aspektin fetar islam, ku gjatë 23 viteve të rimëkëmbjes së lirive fetare, janë shkruar libra të shumtë, me dobi e vlerë. Në këtë kuadër, ka spikatur kontributin e thirrësit islam

Imam Muhamed Sytari, duke u përqendruar në një analizë të hollësishtme të librit më të ri, pas një leximi tërësor të tij.

Shkrimtari Xhahid Bushati ka vlerësuar cilësitë letrare, me të cilat është shkruar ky libër, si një vlerë për autorin, Myftininë Shkodër dhe historinë e saj. Njëkohësisht ka uruar autorin për punë të mëtejshme dhe botime të reja në dobi të lexuesit.

Teologu Lavdrim Hamja, në fjalën e tij, është përqendruar te vlera që ka shkrimi i historisë së realitetit islam nga protagonistët e tij të drejtpërdrejtë, duke iu referuar shembullit të Myftiut aktual të Shkodrës, i cili, nëpërmjet librit në fjalë, ka dhënë një kontribut të pastër në pasqyrimin e jetës fetare, problematikave të Thirrjes Islame në vend, pengesave dhe dinamikës së aktivitetit fetar në Shkodër.

Aktiviteti është përshëndetur edhe nga H. Fejzi Zaganjori, imam i xhamisë Rus, në fjalën e të cilit është vlerësuar libri dhe shpirti i mesazheve që ai përcjell në 255 faqet e tij.

Njëkohësisht ka bërë disa propozime të vyera për Myftininë Shkodër dhe vlerësimin e mëtejshëm të kontributeve të imamëve teologë të



Shkodrës dhe botimeve të tyre.

Me shumë interes është ndjekur edhe fjala e autorit të librit "Nún Pasha Lapsin", Imam Muhamed Sytari. Fillimisht, autori ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen dhe vlerësimin e ftesës.

Në fjalën e tij ka shpjeguar arsyet e botimit të këtij libri dhe përgjegjësinë që ka drejtimi i një myftinie si ajo e Shkodrës "në një kohë, kur qyteti ka kohë që jeton në mesin e hijeve, intrigave, pengesave dhe një tendence mesjetare për ta mbytur emrin e tij dhe për t'i dhënë një ngjyresë që nuk është e tij".

Në fjalën e tij Myftiu ka thënë se gjatë 23 viteve të fundit, hijet e islamofobisë dhe ekstremizmit politik, e kanë dëmtuar jo pak Thirrjen Islame në Shkodër e në mbarë vendin. Por, ai ka theksuar se ka ardhur koha që çdo musliman të dëshmojë fenë e tij pa ndrojtje dhe të jetë shembull pozitiv e ndërtues në shoqëri.

Myftiu nuk ka lënë pa përhëndetur edhe të gjithë pararendësit e tij në detyrën e Myftiut të Shkodrës, duke theksuar se secili ka një kontribut, që duhet matur dhe vlerësuar duke njohur dhe spikatur edhe rrethanat e kohës, në të cilën ata shërbyen.



“(Dekadenca e muslimanëve)

është një tragjedi e përgjithshme njerëzore,

që nuk ka dëshmuar historia më të rëndë


e më të gjithanshme sesa ajo! ...

Bota, akoma sot, nuk e ka bërë si duhet

llogarinë e kësaj ndodhie!”

Shejkh Ebul-Hasan En-Nedevi

(1914-1999)



“BULETIN”, NR. 3

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

E-mail:
udhaislame@myftinia-shkoder.org
Website:
www.myftinia-shkoder.org